

Problema me 3 pikë

1. Fotografia në të djathtë tregon një mollëkuqe. Cila nga alternativat më poshtë tregon të njëjtën mollëkuqe ?




- (A) (B) (C) (D) (E)

2. Cila nga figurat e plotëson enigmën (puzzle-in)?



- (A) (B) (C) (D) (E)

3. Qeni vrapon nëpër labirintin e treguar. Sa kocka mund të arrijë qeni gjithsej?



- (A) 8 (B) 9 (C) 10 (D) 11 (E) 12


4. Miqtë e Anës vijnë për vizitë dhe i heqin këpucët. Këpucët e tyre janë treguar në figurë.



Sa miq kanë ardhur për vizitë?

- (A) 6                      (B) 7                      (C) 8                      (D) 12                      (E) 14


5. Në një lojë me hedhje unazash, lojtarët marrin 3 pikë për çdo unazë që bie te shtylla.








Sa pikë gjithsej marrin lojtarët në lojën e paraqitur?

- (A) 3                      (B) 6                      (C) 9                      (D) 12                      (E) 15


6. Bernardi ka fillimisht 6 monedha mbi tavolinë, ashtu siç paraqitet në figurë.




Secila monedhë është blu në njëren anë dhe e bardhë në anën tjetër. Çfarë do të shikojë Bernardi pasi t'i kthejë mbrapsht të gjitha monedhat nga një herë?




7. Figura paraqet 2 familje të ndryshme përbindëshash.



Cili nga këto grupe përbëhet nga përbindësha të së njëjtës familje?



8. Sa katrorë të gjelbër më shumë se katrorë të bardhë ka në fotografi?



- (A) 4                      (B) 5                      (C) 6                      (D) 7                      (E) 8

Problema me 4 pikë

9. Alba shkruan tre shkronjat e para të alfabetit në një dritare. Më pas ajo vizaton një zemër pas shkronjës së fundit.

A B C ♥

Çfarë mund të shihet nga ana tjetër e dritares?

- (A) A B C ♥                      (B) ♥ B C A                      (C) ♥ A B C  
 (D) C B A ♥                      (E) ♥ C B A


10. Disa bletë janë vendosur në dy rrethë.



Sa bletë duhet të kalojnë nga rrethi A te rrethi B që të ketë numër të barabartë bletësh në çdo rreth?

- (A) 1                      (B) 2                      (C) 3                      (D) 4                      (E) 5


11. Gjyshja e ndan një tortë me 3 prerje. Më pas ajo e rrotullon tortën dhe bën edhe 4 prerje, ashtu siç paraqitet në figurë.



Sa pjesë torte janë tani?

- (A) 14                      (B) 16                      (C) 18                      (D) 20                      (E) 21


12. Papagallit Pjer i duhen 2 sekonda për të kërcyer nga një shtyllë në tjetrën.




Pjeri kërcen nga shtylla e parë te shtylla e dhjetë, një shtyllë në çdo herë. Sa sekonda do t'i duhen Pjerit për të arritur tek shtylla e dhjetë?

- (A) 10                      (B) 16                      (C) 18                      (D) 20                      (E) 22


13. Një enigmë (puzzle) me kangur ndahet në pesë pjesë. Katër nga pjesët paraqiten në anën e djathtë.



Cila pjesë mungon?



14. Kastori Billi po ngjyros shkronjën K në figurën e treguar.



Ai ka shpenzuar tashmë 1 tub bojë. Sa tuba bojë të tjera i nevojiten për të mbaruar ngjyrosjen e shkronjës?

- (A) 2                      (B) 3                      (C) 4                      (D) 5                      (E) 6


15. Stefania ka 3 libra: 1 blu, 1 të verdhë dhe 1 të kuq.








Libri i verdhë ka 4 faqe më tepër sesa libri i kuq.  
Libri i verdhë ka 7 faqe më tepër sesa libri blu.  
Sa faqe më pak sesa libri i kuq ka libri blu?

- (A) 3                      (B) 4                      (C) 7                      (D) 10                      (E) 11

16. Kubi i madh i treguar në fotografi është i përbërë prej 18 kubesh blu dhe 9 kubesh të verdhë.



Danieli shikon anën e majtë, siç tregohet nga shigjeta. Çfarë sheh ai?



Problema me 5 pikë

17. Flori ka ndërtuar 6 kulla duke përdorur blloqe të gjelbër dhe blloqe blu.



Secila kullë përbëhet nga 5 blloqe. Blloqet me ngjyrë të njëjtë nuk preken me njëri-tjetrin. Nga sipër, kullat shihen ashtu siç paraqitet në figurë.



Sa blloqe blu ka përdorur Flori gjithsej?

- (A) 10                      (B) 12                      (C) 15                      (D) 16                      (E) 20







18. Tabela është plotësuar duke kombinuar formën e treguar në të majtë të çdo rreshti me kafshën e treguar në krye të çdo kollone. Frenku më pas ka derdhur bojë mbi disa kutiza, ashtu siç është treguar.



Cila figurë është e fshehur poshtë X-it?

- (A)                      (B)                      (C)                      (D)                      (E)






19. Cilën figurë nuk është e mundur ta krijosh me 2 pllakat e dhëna?



20. Anila po bën një byzylyk duke vënë rruaza në një fije.

- Fillimisht, ajo vendos 2 rruaza të bardha në anën e majtë të fijos,
- pastaj 1 rruazë të zezë në anën e majtë të fijos,
- pastaj 2 rruaza të zeza në të djathtë,
- pastaj 2 rruaza të bardha në të majtë,
- pastaj 1 të bardhë në të djathtë dhe 1 të zezë në të majtë.

Cila figurë tregon byzylykun e Anilës kur ajo e mbaron atë?



21. Arini, Darini dhe Marini arritën në palestër në kohë të ndryshme.

- Arini thotë: "Unë arrita i pari."
- Marini thotë: "Unë arrita para Arinit."

Të dy djemtë po gënjejnë. Në çfarë radhe arritën djemtë në palestër?

(A) Arini, më pas Marini, më pas Darini


(B) Marini, më pas Darini, më pas Arini

(C) Darini, më pas Marini, më pas Arini

(D) Marini, më pas Arini, më pas Darini

(E) Darini, më pas Arini, më pas Marini


22. Rajani ka tri karta dhe dy zarfe.



Ai fut nga një kartë në secilën zarf pa e rrotulluar atë. Ai mund të shohë dy numra nëpër dritaret e çdo zarfi. Shuma e 4 numrave të dukshëm është 26. Cilën kartë ka vënë ai në secilin zarf?

- (A) Karta 1 në zarfin A; Karta 3 në zarfin B
- (B) Karta 2 në Zarfin A; Karta 1 në zarfin B
- (C) Karta 3 në zarfin A; Karta 1 në zarfin B
- (D) Karta 3 në zarfin A; Karta 2 në zarfin B
- (E) Karta 2 në zarfin A; Karta 3 në zarfin B

23. Martina ka vendosur dhjetë monedha me numra në dy rreshta, ashtu siç paraqitet në figurë.



Ajo dëshiron të shkëmbejë një monedhë nga rreshti i parë me një nga rreshti i dytë në mënyrë që numrat në secilin rresht të kenë të njëjtën shumë. Cilën monedhë duhet të marrë ajo nga rreshti i parë?

- (A) 5
- (B) 7
- (C) 11
- (D) 15
- (E) 17

24. Në Stamboll, një mace ka 7 kotele. Një nga kotelet meshkuj quhet Albert, dhe një nga kotelet femra quhet Stela. Stela ka dyfish më shumë vëllezër se sa ka Alberti. Sa motra ka Stela?

- (A) 1
- (B) 2
- (C) 3
- (D) 4
- (E) 5